Sesioni 22: Beteja Shpirtërore

Në këtë sesion, ju do të zbuloni çfarë thotë Bibla mbi mbi luftën tonë shpirtërore me Satanin dhe shpirtrat e këqinj, dhe për mposhtjen e sulmeve të tij.

Zemra e Drejtuesit (40 min)

- Adhuroni së bashku në grup të madh.
- Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në grupe prej 3-4 personash dhe të diskutojnë pyetjet e mëposhtme:
  - Çfarë po mësoni mbi të qëndruarin në Krishtin? Si po e praktikoni të qëndruarin në Të përmes Fjalës së Tij, lutjes, bindjes, LKN, marrëdhënieve dhe qëndrimit së bashku?
  - A keni ndonjë konflikt të pazgjidhur akoma?
  - Në cilat fusha të jetës e keni të vështirë bindjen ndaj Zotit?
  - Çfarë ndodhi ndërsa i besuat Zotit qëllimet tuaja nga takimi i kaluar?

Dhënia e Vizionit për Zemrën

Disa herë, gjatë sprovave të frikshme të jetës ne ndihemi shumë të vetmuar dhe të trembur. Ndjenjat tona rrallë janë në lartësinë e realitetit më të asaj që ne jemi ne në planin e përjetshëm të Perëndisë. Veçanërisht ndërsa përpiqemi të ndjekim Jezusin me bindje, duke përjetuar çdo ditë mbretërinë e tij, duke zbuluar karakterin dhe prioritetet e tij, ne do të ndeshemi me kundërshtime. Armiqtë e Jezusit do t'i kundërvihen punës së tij. Jezusi u premtoi ndjekësve të vet që pavarësisht se si ndiheshin ata, realiteti është që ai premtoi se: "unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës. Amen." (Mat 28:20). Njohja e faktit që Zoti na ka dërguar nëpër botë, na ka pajisur dhe fuqizuar, është jetësore, por besimi që ai në fakt është gjithmonë i pranishëm pranë nesh, është transformues. Lexoni Psalmin 23. "Edhe sikur të ecja në luginën e hijes së vdekjes, nuk do të kisha frikë nga asnjë e keqe, sepse ti je me mua."

Kremtimi i Besnikërisë (20 min)

[SHËNIM: Kremtoni Besnikërinë në grup të madh në mënyrë që të gjithë të përfitojnë dhe të inkurajohen.]

- Jepuni mundësi pjesëmarrësve të ndajnë me të tjerët çfarë u ka ndodhur që nga hera e fundit që jeni takuar. Kërkojuni atyre ta lidhin ndarjen me qëllimet e takimit të kaluar.

Hekuri-hekurin: Mprehja e Vetvetes dhe e të Tjerëve (45 min)

Fjalët e Urta 27:17 "Hekuri mpreh hekurin, kështu njeriu mpreh fytyrën e shokut të tij."

- Kërkojuni të gjithëve të ndahen sipas grupeve të tyre Hekuri-Hekurin, të skicojnë rrjetin e tyre të komuniteteve të misionit dhe të kishave, dhe më pas të ndajnë dhe vlerësojnë njëri-tjetrin në grupet e tyre.

  1. Çfarë po shkon ashtu si duhet?
  2. Çfarë nuk po shkon si duhet? Cilat janë pengesat me të cilat po përballeni?
  3. Cilat janë disa zgjidhje të mundshme nga anëtarët e tjerë të grupit?
  4. Çfarë duhet të bëni për të shtuar karakteristikat që mungojnë në secilin grup?
  5. Ku do ta filloni një grup të ri apo një kishë gjatë këtij muaji?

- Kërkojuni të vendosin objektiva për përmirësim nga ky vlerësim dhe t'i ndajnë ato me grupin e tyre të vogël. Më pas kërkojuni të luten për njëri-tjetrin.

Mësimi i Ri (45-60 min)

Tema: Përse është e rëndësishme dhe ndihmëse të dimë mënyrat që mund të përdorim për t'i rezistuar me sukses Satanit?

- Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në grupe të reja prej 4-5 vetash (ose mund të vazhdojnë në grupet e tyre Hekuri-Hekurin)
- Në seksionin në vazhdim, kërkojini çdo grupi të caktojnë nga një pasazh për çdo person në grup. Secili duhet të lexojë pasazhin dhe t'i tregojë grupit çfarë mësojnë prej tij.

Studim Biblik Zbulues – Beteja Shpirtërore

Seksioni 1: Nga vijnë Shpirtrat e Këqinj?

Perëndia krijoi të gjitha gjërat e Dukshme dhe të Padukshme: Nehemia 9:6; Kolosianëve 1:16
Qëllimi i Ëngjëjve: Zbulesa 5:10; Hebrenjve 1:14
Satani: Ezekieli 28:12-19; Isaia 14:12-14; Zbulesa 12:7-10

- Pasi të kenë ndarë të gjithë vargjet që u janë caktuar, kërkojini çdo personi të grupit të thotë:
  - Çfarë u tërhoqi vëmendjen (ose çfarë ju pëlqeu më shumë)? Përse?

Përmbledhje: ***Perëndia i Madhërishëm mund të krijojë gjithçka që dëshiron. Perëndia krijoi dhjetëmijëra dhjetëmijërash me engjëj (Zbulesa 5:11). Ata u krijuan të përkryer dhe pa asnjë mëkat. Engjëjt janë frymë. Ata e adhurojnë Perëndinë si shërbëtorët e Tij. Dikur ishte një engjëll i cili ishte shumë i bukur dhe i mençur, dhe quhej Lucifer. (Ezekieli 28:12) Por, me kalimin e kohës, Luciferit iu rrit mendja dhe u bë krenar (Ezekieli 28.13-19) dhe dëshironte të sundonte njëlloj si Perëndia. Luciferi udhëzoi shumë engjëj të tjerë që të rebeloheshin kundër Perëndisë. Por Perëndia e dinte që Luciferi kishte mendime të këqia. Rebelimi dështoi sepse Perëndia është i gjithëdijshëm dhe i gjithëpushtetshëm.***

Engjëjt e rënë mëkatuan kundër Perëndisë. Prandaj Perëndia i përzuri nga parajsa dhe i hodhi poshtë në tokë (Zbulesa 12:7-9). Perëndia tha që një ditë Ai do t'i ndërshkojë në përjetësi engjëjt që kanë mëkatuar. Ai e ndryshoi emrin e Luciferit, që do të thotë "dritë", në Satan, që do të thotë "mashtrues". Satani dhe engjëjt mëkatarë u bënë armiq të Perëndisë sepse ata ishin kundër Atij. Engjëjt që iu bashkuan Satanit tani quhen shpirtra të këqinj ose demonë. Ata bëjnë rezistencë ndaj së vërtetës dhe nuk duan ta dëgjojnë Fjalën e Perëndisë. Ata janë mashtrues.

Seksioni 2: Beteja

Dy plane: Gjoni 10:10; Kolosianëve 2:15; 1 Pjetrit 5:8

Puna e Satanit: Danieli 10:2-14; 2 Korintasve 11:14; Galatasve 1:6-9; 2 Korintasve 4:4

E ardhmja e Satanit: Zbulesa 20:10

Autoriteti i Jezusit**:** Luka 10:17-19; 1 Pjetrit 3:22; Efesianëve 1:20-22

Paralajmërime për Praktikat e Liga: Ligji i Përtërirë 18:10-14; 2 Kronikave 33:6; Galatasve 5:19-21

Përgjigja jonë: Veprat e Apostujve 19:18-20; 1 Gjonit 4:4; Jakobi 4:7; Efesianëve 6:10-18

- Pasi të kenë ndarë të gjithë vargjet që u janë caktuar, kërkojini çdo personi të grupit të thotë:
  - Çfarë u tërhoqi vëmendjen (ose çfarë ju pëlqeu më shumë)? Përse?

Përmbledhje*: Satani dhe demonët disa herë shtiren sikur janë engjëj të dritës. Disa herë shpirtrat e këqinj do të pretendojnë sikur sjellin mësime të reja nga Perëndia, apo mesazhe përmes ëndrrave (Galatasve 1:6-9, Juda 8-9). Mos i ndiqni ato. Disa herë shpirtrat e këqinj i tundojnë njerëzit duke u dhënë atyre pushtet apo forcë. Ata mund të japin fuqi për të shëruar përmes frymërave, gurëve të veçantë, apo bëjnë magji, në mënyrë që ne të varemi te ajo fuqi dhe jo te Perëndia. Nëse ndjekësit e Jezusit ndonjëherë do të përdorin fuqi nga shpirtrat e këqinj, ata duhet të pendohen dhe të heqin dorë nga këto praktika të këqia. Shpirti i Shenjtë brenda nesh është më i madh dhe ka më shumë fuqi sesa shpirtrat e kësaj bote. Jezusi ka fuqi mbi Satanin dhe shpirtrat e tij të këqinj. Prandaj, besimtarët duhet t'ia nënshtrojnë veten Perëndisë, t'i rezistojnë djallit, t'i afrohen Perëndisë dhe të falenderojnë Atë që u ka dhënë fitore mbi tundimet e Satanit.*

Konkluzioni: Luciferi (Satani) u Kthye në Armikun e Perëndisë

1. ***Luciferi dëshironte postin e Perëndisë dhe të bëhej si Perëndia (Isaia 14:13-14).***
2. ***Një e treta e engjëjve ndoqi Luciferin (Zbulesa 12:3-4).***
3. ***Perëndia e zbriti Luciferin nga posti dhe e hodhi atë në Tokë (Ezekieli 28:17).***
4. ***Satani e tundon njeriun dhe e kundërshton planin hyjnor për këtë botë, duke përfshirë mashtrimin e njerëzve dhe akuzimin e njeriut para Perëndisë (Zbulesa 12:10).***
5. ***Në kohët e fundit, Perëndia do ta hedhë Satanin dhe engjëjt që e ndoqën atë në ferr, atje ku ai do të mundohet në përjetësi (Zbulesa 20:10, 15).***
6. ***Fati i Satanit dhe Shpirtrave të Këqinj: Filloi në Parajsë > U hodhën në Tokë për një farë kohe > Do të dëbohen në ferr për gjithë përjetësinë.***

Përgatitja për Mision (20 min)

- Në grupe të vogla, kërkojini çdo pjesëmarrësi të **Vlerësojë** pikat e forta dhe të dobëta në rezistimin ndaj planeve të Satanit dhe të **Hartojë një Plan** për t'u përmirësuar në këtë fushë.
  - **Lutuni** për çdo pjesëmarrës që mund të ketë bërë një zotim apo premtim ndaj një fryme (përveç Jezusit), që të mund të jetojë në nënshtrim ndaj Krishtit dhe të çlirohet nga pushteti i Satanit.
- Shkruani deklaratat "Unë do të____më datë____". Përfshini "Kujt do t'ia shpjegoni këtë mësim?"
- Praktikoni ndonjë aftësi shtesë që mund t'u shërbejë drejtuesve për të drejtuar grupet e tyre apo të fillojnë një grup të ri.

Dërgimi i Punëtorëve

- Përforconi vizionin e përgjithshëm: një kishë ose komuniteti i besimit për çdo 1,000 persona.
- Kaloni kohë në lutje:
  - dorëzojani Zotit qëllimet e gjithsecilit;
  - që Perëndia të ngrejë një lëvizje kishash;
  - për më shumë punëtorë për të korrat.